



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION


Vendim i Këshillit të KPM-së në lidhje me kërkesat e reja për frekuenca dhe ndryshime të licencave aktuale nga subjektet transmetuese të licencuara

Në takimin e 20të me radhë të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media (KPM) të mbajtur më 12 janar 2009, Këshilli i KPM-së ka diskutuar për kërkesat e reja të paraqitura deri më tani në KPM për frekuenca radio-televizive. Poashtu është diskutuar edhe për kërkesa të paraqitura nga disa subjekte tashmë të licencuara për frekuenca shtesë me qëllim të zgjerimit të mbulueshmërisë së tyre.

Gjatë muajit shkurt 2009 Këshilli i KPM-së fillon procesin e licencimit afatgjatë (ri-licencimit), i cili do të përfundojë në dhjetor 2009. Me këtë proces, përmbushet një obligim ligjor i KPM-së.

Poashtu, Komisioni i Pavarur për Media është në proces të rishikimit dhe analizimit të planit frekuencor analog në mënyrë që frekuencat që do të caktohen dhe ri-caktohen gjatë procesit të licencimit afatgjatë të jenë frekuenca të koordinuara dhe të lira nga interferencat. Me miratimin e këtij plani të rishikuar frekuencor, Këshilli I KPM-së bazuar në disponueshmërinë e frekuencave të lira do të përcaktojë edhe strategjinë për licencimin e radio dhe TV stacioneve të reja.

Prandaj, Këshilli i KPM-së vendos që kërkesat e reja tashmë të paraqitura për licencë të KPM-së dhe për zgjerime të mbulueshmërisë së mediave (ndryshime të theksueshme të Pjesës II dhe IV të Licencës së KPM-së) nuk do të shqyrtohen deri në përfundim të procesit të licencimit afatgjatë.


Argjentina Grazhdani

Kryetare e Këshillit të KPM-së



14 janar 2009
0901/0047/CIMC/ag